

KONTRATE SHIT-BLERJE
(AKSIONESH)

Në Tiranë, sot me datë 03/05/2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë) palët e mëposhtme kane rane dakort per hartimin/nenshkrimin e kontrates si me poshte:

1. Kujtim SULAJ, shtetas Shqiptar ,lindur me 08/07/1957 në Panahor, Fier dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me Nr.Personal F70708101T, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për te vepruar (referuar më poshtë si Shitësi),

2. Aurel BAKA, shtetas Shqiptar ,lindur me 11/03/1985 në Korçe dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me Nr.Personal I50311084D, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për te vepruar (referuar më poshtë si Blerësi),

Të përgjithshme

A. Shoqëria “PARID TRANS OIL” SHA, shoqëri aksionere e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 06/01/2017, me NIPT L71306015O, me seli në Tiranë , Fshati Gjokaj, Bashkia Vore, Zona Kadastrale 1751, Pasuria Nr,447/42, 447/43 Shoqëri e cila zotërohet nga Z.Kujtim SULAJ në masën e 100% të aksioneve si më poshtë:

Kujtim SULAJ, shtetas Shqiptar ,lindur me 08/07/1957 në Panahor, Fier dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me Nr.Personal F70708101T, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për te vepruar, zotërues i 100 (njëqind) % të aksioneve.

B. Me vendim të Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë “PARID TRANS OIL” SHA është miratuar shitja e të gjitha aksioneve të shoqërisë në emër te Z. Kujtim SULAJ dhe në këtë mënyrë aksionar i vetem bëhet Z. Aurel BAKA, ndërsa Z. Kujtim SULAJ del si aksionar nga kjo shoqëri.

C. Në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar, Ligjin Nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar, Statutit dhe akteve të shoqërisë si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Palët bien dakord të pranojnë kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti



- Objekti i kësaj kontrate është shitja e të gjitha aksioneve që përfaqësojnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë “PARID TRANS OIL” SHA. Këto aksione transferohen nga Shitësi në pronësi të Blerësit.
- Blerësi pranon pronësinë e aksioneve dhe pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi sipas ligjeve në fuqi.
- Nëpërmjet transferimit të aksioneve që përfaqësojnë 100 % të kapitalit themeltar nga Shitësi tek Blerësi, Blerësi Z. Aurel BAKA bëhet Aksionar i Vetëm i Shoqërisë “PARID TRANS OIL” SHA, ndërsa Shitësi nuk ka më asnjë të drejtë mbi shoqërinë.

Neni 2

Çmimi i Shitjes dhe Mënyra e Kryerjes së Pagesës.

- Palët bien dakord që çmimi total për blerjen e të gjitha aksioneve është 1.000.000 (nje milion) Lekë, çmimi i shitjes është shlyer tërësisht nga blerësi.

Neni 3

Garancitë

- Shitësi garanton Blerësin se është pronari i vetëm dhe i ligjshëm i aksioneve objekt shitje.

Neni 4

Regjistrimi

- Regjistrimi i kontratës së shitjes së aksioneve kryhet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar.

Neni 5

Ligji i zbatueshëm

- Kjo kontratë rregullohet nga ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar; Ligji Nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.


Neni 6

Juridiksioni

- Për çdo mosmarrëveshje që mund të lind gjatë zbatimit të kësaj kontrate, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7

Të ndryshme

- Palët bien dakort që kalimi i pronësisë së aksioneve të shoqërisë bëhet në momentin e regjistrimit të kontratës së shitjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Bashklidhur kontratës do të jenë ID e palëve, ekstrakt i Shoqërisë si dhe Vendim i Asamblesë për miratimin e shitjes së aksioneve.
- Kjo kontratë është përfundimtare ndërmjet palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe/ose mosmarrëveshjet e mëparshme midis tyre me shkrim apo me gojë.

Kjo kontratë u përpilua në 3 kopje me vlerë të barabartë ligjore, nga të cilat një kopje iu takon palëve dhe një kopje të fundit për ta regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

PALET


Shitësi


Blerësi

Kujtim SULAJ

Aurel BAKA

Kujtim Sulaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A
PARID TRANS OIL
Nume: L 71306015 O
TIRANË - ALBANIA

Aurel Baka



30/06